

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E VUSHTRRIË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **VU644-25-2905-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **“Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

CENTER FOR LEGAL SERVICES L.L.C.

Rr. “Ali Vitia” Ob. 4 H.3 B.7

Prishtinë

10000

049 11 33 58

(Numri i Faks-it)

Adrianit Ibrahim

info@cls-rks.com

16.05.2025

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]

Njoftimi për kontratë – 08.04.2025
Njoftimi B58 mbi vendimin – 05.05.2025
Kërkesa për rishqyrtim – 12.05.2025
Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim – 13.05.2025
Ankesa në OSHP – 16.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim – 12.05.2025
Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim – 13.05.2025
Ankesa në OSHP – 19.05.2025

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 59 par. 4 i LPP

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK-Komuna e Vushtrrisë me datë 05.05.2025 ka publikuar njoftimin mbi vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë OE "Ekrem Q. Salihu B.I.". Së bashku me këtë vendim AK ka bashkangjitur edhe një letër standarde sipas të cilit OE "Juris Concept LLC" është OE i pasuksesshëm. Brenda afatit ligjor kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim përmes të cilës kemi prezantuar argumentet tona të matshme dhe të ligjshme sipas të cilave edhe tenderuesi i rekomanduar "Ekrem Q. Salihu B.I." por edhe OE "Juris Concept LLC" kanë dorëzuar ofertë administrativisht të papërgjegjshme (pra nuk kanë plotësuar kushtet administrative) mirëpo nuk kanë përmbushur as kërkesat e DT.

Me datë 13.05.2025 AK përmes ZPP ka publikuar një vendim përmes të cilit thuhet që kërkesa jonë për rishqyrtim "miratohet pjesërisht"! Fillimisht ky vendim nuk tregon se cilat nga pretendimet tona janë të bazuara dhe cilat janë të pabazuara apo pjesërisht të bazuara sipas AK. Pra ne kemi parashtruar pretendime konkrete, të formuluar në mënyrë konkrete dhe të mbështetura me argumente juridike specifike. Nëse kërkesa jonë për rishqyrtim qenka miratuar pjesërisht, atëherë është detyrim që AK të sqarojë se cila pjesë e kërkesës është miratuar dhe cila jo. Në fakt pretendimet tona nuk janë shqyrtuar fare në AK, dhe të njëjtat as që citohen (parafrazohen apo referohen) fare në vendimin e kontestuar me këtë ankesë. Përkundër faktit që aktiviteti i prokurimit është kthyer në rivlerësim, ne konsiderojmë që të gjitha pretendimet tona ankimore janë të bazuara dhe lidhur me këtë fakt kemi prezantuar argumente dhe prova të detajuara respektivisht të mjaftueshme për të bindur AK në këtë drejtim. Rrjedhimisht konsiderojmë që AK është dashur që të shqyrtoj të gjitha pretendimet tona ankimore një nga një dhe të ofroj përgjigje konkrete për secilin prej tyre. Vlen të ceket se i gjithë arsyetimi i vendimit të AK duket si në figurën vijuese:

Në arsyetimin e Kërkesës për rishqyrtim, OE Center for Legal Services L.L.C., Rr. "Ali Vitia", Ob.4, H.3, B.7, 10000, Prishtinë, Kosovë, Personi kontaktues: Adrianit Ibrahimit, Numri fiskal: 812117267, (në tekstin e mëtejshëm Ankuesi) pretendon se, A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht:

Neni59 par.4 i LPP-se.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, gjatë fazës së shqyrtimit paraparak ka konstatuar se ankesa i përmban elementet e përcaktuara përmes nenit 60 paragrafi 3 të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 108/A paragrafin 3.1 të LPP në procedurë paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë AK ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë kërkesë sipas nenit 108/A të LPP lidhur me nenin 63 të RRPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e saj në mënyrë meritore.

Autoriteti Kontraktues, pasi shqyrtoi një nga një pretendimet e OE ankues të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim në kontekstin e përgjithshëm të kërkesave dhe kushteve të zbatueshme të dosjes së tenderit/njoftimit për kontratë, fakteve të pohuara nga OE ankues, duke pasur parasysh natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe duke u mbështetur në në LPP dhe RRPP, **gjeti se kërkesa për rishqyrtim Apropohet pjesërisht e bazuar**.

1. Pretendimet e ngritura janë marrë në shqyrtim secila një nga një dhe konform kërkesës për rishqyrtim AK ka vendosur që këtë AP ta kthejë në RI-VLERESIM,

Sa i përket pohimeve të ngritura për shkelje të neneve të LPP-së, A.K. thekson se ky pohim është paragjykses, pasi që në kontekstin e rrethanave konkrete kjo dispozitë nuk ka të bëjë me çështjen konkrete, respektivisht nuk është e aplikueshme ose nuk ndërlidhen në situatën dhe procedurën e tanishme të këtij aktiviteti të prokurimit.

Konsiderojmë që vendimi i AK për miratimin e kërkesës tonë vetëm pjesërisht është vendim i padrejtë pasi që është dashur që kërkesa jonë për rishqyrtim të miratohet si e bazuar në tërësi duke konfirmuar të gjitha pretendimet tona ankimore. Për këtë arsye është parashtruar kjo ankesë pranë Paneli Shqyrtues në OSHP dhe në vijim po përsërisim të gjitha pretendimet tona ankimore në formën identike sikurse janë prezantuar edhe pranë AK përmes kërkesës për rishqyrtim. Shpresojmë që Paneli Shqyrtues në OSHP do të caktoj një ekspert shqyrtues për të bërë vlerësimin fillestar të këtyre pretendimeve në mënyrë që pastaj edhe Paneli Shqyrtues në OSHP të mund të shqyrtoj pretendimet tona ankimore dhe të vendos sikurse në dispozitivin e propozuar në fund të kësaj ankese.

Pretendimi nr. 1 kundër tenderuesit të rekomanduar OE “Ekrem Q. Salihu B.I.”:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Vushtrrisë (tutje si “AK”) ka rekomanduar për kontratë një operator ekonomik (“OE”) i cili është tërësisht i papërgjegjshëm. Kjo për arsye se tenderuesi i rekomanduar OE “Ekrem Q. Salihu B.I.” nuk ka plotësuar si duhet formularin e tenderit përkatësisht nuk e ka precizuar çmimin e ofertës së tij. Ky fakt konfirmohet përmes procesverbalit të hapjes së ofertave të dt. 30.04.2025 ku tenderuesi i rekomanduar në rubrikën për çmimin total me TVSH ka ofertuar me 2125.86 euro. Mirëpo edhe në rubrikën e çmimit të ofertës pa TVSH sërish ka ofertuar me çmimin e njëjtë prej 2125.86 euro. Shih fig.

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

| | | | |
|---|---------------------|--|--|
| Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke: | VU644-25-2905-2-2-1 | Titulli i Kontraktit Contract Title Naslov ugovoru | Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës |
| Numri i brendshëm Internal No Interni broj | | | |

| | | | | |
|---|---|---|-------------------------|---|
| Data e Jëshimit Date of issue Datum izdavanja | Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas | Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas | Vendi Place Mesto | Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera |
| 30.04.2025 | 30.04.2025, 14:00:00 | 30.04.2025, 14:00:00 | | 4 |

| Nr. Br. | Tenderuesi Tenderer | Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude | Pjesë Lot Lot | e-tenderit e-tender e-ponuda | Çmimi Price Cena € | Çmimi me TVSH Price (with VAT) Cena (sa PDV) € | Ndërshtimi/plotësimi Supplement/Amendment Dopuna/Izmenjena |
|---------|--|--|---|------------------------------------|-----------------------------|---|--|
| 1. | Ekrem Q. Salihu B.I. Syljeman Vokshi Nr. 64, 10000, Prishtinë | VU25 | Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës | PO | 2125.86 | 2125.86 | JO |
| 2. | Center for Legal Services L.L.C., Rr. "Ali Viti", Ob.4, H.3, B.7, 10000, Prishtinë | CLS-VU-2905 | Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës | PO | 1984.05 | 2341.18 | JO |
| 3. | SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K., rr.Garibaldi, hyrja 3, kati 2, nr.7, 10000, Prishtina | Shërbime juridike Komuna e Vushtrrise | Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës | PO | 1439.90 | 1439.90 | JO |
| 4. | Juris Concept L.L.C., Rr. "Garibaldi", H 11, K 2, Nr. 5, 10000, Prishtinë | Shërbime ligjore- Vushtrri 2025 | Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës | PO | 1851.60 | 2258.05 | JO |

Në këtë mënyrë tenderuesi i rekomanduar ka dështuar që të përcaktoj çmimin e ofertës së tij (pra mungon çmimi) por njëkohësisht nuk është plotësuar si duhet as formulari elektronik i tenderit përmes platformës eprokurimi. Që të dy këto gabime të tenderuesit të rekomanduar përbëjnë KUSHTE ADMINISTRATIVE të përcaktuara sipas pikës 10 të UPP ku thuhet se në rastet kur nuk precizohet apo mungon çmimi, tenderi duhet refuzuar pa kërkuar informacione shtesë. Njësoj veprohet edhe kur nuk plotësohet si duhet formulari i tenderit.

| | | |
|--------------|--|---------------------|
| Mungon çmimi | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm | Kusht administrativ |
|--------------|--|---------------------|

UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

| | | |
|---|--|---------------------|
| Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm | 68 |
| Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm | Kusht administrativ |
| Lista e çmimeve është plotësuar por nuk është nënshkruar (tenderët e | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm | Kusht administrativ |

Nga sa u tha më sipër, OE "Ekrem Q. Salihu B.I." ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme prandaj duhet eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të shpërblehet me kontratë.

Pretendimi nr. 2 kundër tenderuesit të rekomanduar OE "Ekrem Q. Salihu B.I.":

Tenderuesi i rekomanduar në ofertën e tij nuk ka dorëzuar paramasën e cila ka qenë pjesë e DT sikurse është publikuar në eprokurim. Me fjalë të tjera tenderuesi i rekomanduar ka ndërhyrë në paramasë duke shtuar edhe një kolonë të re jo vetëm në një pozicion të caktuar por në komplet paramasën.

Paramasa e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar duket si në vijim:

| Kategoria A | Mbrotjtja dhe përfaqesimi në çeshtje penale | | | | | | (Kategoria A 20% e piktëve në vlerësim) | (Kategoria A 20% e piktëve në vlerësim) |
|---|---|---------|---|----------|---------------------------|---------|---|---|
| Mbrotjtja e të dyshuarit, të pandehurit dhe përfaqesimi i të dëmtuarit | | | | Baza | 30 % për çdo orë të bluar | P. 30% | Gjithsejt: | Gjithsejt çmimi me TVSH |
| 1 | Për vepr penale nga kompetenca e Departamentit të përgjithshëm të Gjykatës/Prokurorisë. | Shërbim | 1 | 60.00 € | 18.00 € | 23.40 € | 101.40 | 119.65 € |
| 2 | Për vepr penale nga kompetenca e Departamentit të krimeve të rënda të Gjykatës/Prokurorisë për vepr penale për të cilat parashihet dënimi deri në dhjet vjet burg | Shërbim | 1 | 75.00 € | 22.50 € | 29.25 € | 126.75 | 149.57 € |
| 3 | Për vepr penale për të cilat parashihet dënimi dhjet e më shumë vjet burg dhe krimet e rënda, nenit 22 i KPPRK | Shërbim | 1 | 100.00 € | 30.00 € | 39.00 € | 169.00 | 199.42 € |
| TOTALIA: | | | | 235.00 € | 70.50 € | 91.65 € | 397.15 | 468.64 € |
| Kategoria B | Përpilimi i parashtresave në procedurën penale: | | | | | | (Kategoria B 30% e piktëve në vlerësim) | (Kategoria B 30% e piktëve në vlerësim) |
| Përpilimi i kallëzimit penal, ankesës për caktim dhe vërdhim të parashikimit kundër aktvendimit për refuzim të kërkesës për rishikim të procedurës apo aktivitetit tjerë penal. | | | | Baza | N/A | P. 30% | Gjithsejt: | Gjithsejt çmimi me TVSH |
| 1 | Për vepr penale nga kompetenca e Departamentit të përgjithshëm të Gjykatës/Prokurorisë. | Shërbim | 1 | 60.00 € | N/A | 18.00 € | 78.00 | 92.04 € |
| 2 | Për vepr penale nga kompetenca e Depart. të krimeve të rënda të Gjykatës/Prokurorisë, për | | | | | | | |

Pra përgjatë gjithë paramasës tenderuesi i rekomanduar sipas dëshirës së tij e ka shtuar edhe një rubrikë të re të cilën e ka plotësuar me disa numra që nuk përputhen as me Tarifën e Odës së Avokatëve dhe as me paramasën që ka qenë pjesë e DT. Përndryshe paramasa e cila ka qenë pjesë e DT në eprokurim ka qenë si vijon:

| Kategoria A Mbrojtja dhe përfaqesimi në çeshtje penale | | | | (Kategori a A 20% e pikëve në vlersim) | | | |
|---|--|---------|---|--|-----------------------------------|--------|-------------|
| Mbrojtja e të dyshuarit, të pandehurit dhe përfaqesimi i të dëmtuarit | | | | Baza | 30 % për çdo orë të filluar | P. 30% | Gjithsejtë: |
| 1 | Për veprë penale nga kompetenca e Departamentit të përgjithshëm të Gjykatës/Prokurorisë. | Shërbim | 1 | | | | 0.00 |
| 2 | Për veprë penale nga kompetenca e Departamentit të krimeve të rënda të Gjykatës/Prokurorisë për veprë penale për të cilat parashihet dënimi deri në dhjetë vjet burg | Shërbim | | | | | 0.00 |
| 3 | Për veprë penale për të cilat parashihet dënimi dhjetë e më shumë vjet burg dhe krimet e rënda, neni 22 i KPPRK | Shërbim | 1 | | | | 0.00 |
| TOTALIA: | | | | 0 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Kategoria B Përpilimi i parashitresave në procedurën penale: | | | | (Kategori a B 30% e pikëve në vlersim) | | | |
| Përpilimi i kallëzimit penal, ankesës për caktim dhe vazhdim të paraburgimit kundër aktvendimit për refuzim të kërkesës për rishikim të procedurës apo aktvendimeve tjera penale. | | | | Baza | N/A | P. 30% | Gjithsejtë: |

Nga sa u tha më sipër, OE “Ekrem Q. Salihu B.I.” ka ndërhyrë në paramasën e DT. Rrjedhimisht ai ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme prandaj duhet eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të shpërblehet me kontratë.

Pretendimi nr. 3 kundër tenderuesit të rekomanduar OE “Ekrem Q. Salihu B.I.”:

Përtej të gjeturave të argumentuara si më sipër, tenderuesi i rekomanduar në pjesën e rekapitullimit të çmimit në kuadër të paramasës, ja ndërhyrë duke shtuar një rubrikë të re me të cilën e ka emërtuar “Çmimi total i peshuar me poentim”. Rrjedhimisht ai ka prezantuar disa çmime për pozicionet përkatëse të paramasës të cilat nuk i ka peshuar sipas kriterëve të përcaktuar me DT mirëpo i ka peshuar në mënyrë krejt të gabuar. Si shembull çmimin për kategorinë A e ka prezantuar si 468.64 të cilën më pas e ka peshuar me 397.15 dhe më tutje e ka ripeshuar sërish me 119.15 euro. Këtë vlerën e fundit që nuk dihet se si është kalkuluar (pra nuk dihet si është arritur deri te kjo shumë), e ka marrë për bazë edhe me rastin e kalkulimit të çmimit final me të cilin ai është rekomanduar për kontratë. Në anën tjetër pesha e kategorisë A ka qenë vetëm 30%. Pra komplet paramasa duke përfshirë edhe rekapitullimin është plotësuar gabimisht nga tenderuesi i rekomanduar. Shih edhe fig. si në vijim:

| R E K A P I T U L I M I | | | | |
|--|------------|--------------------------|-----------------------|----------------------------------|
| Kategoria | Përshkrimi | Çmimi total me TVSH në € | Çmimi total i peshuar | Çmimi total i peshuar me poentim |
| A/30% | Shërbim | 468.64 € | 397.15 | 119.15 |
| B/30% | Shërbim | 360.49 € | 305.50 | 91.65 |
| C/10% | Shërbim | 3,739.13 € | 3168.75 | 316.88 |
| D/10% | Shërbim | 9,137.37 € | 7743.54 | 774.35 |
| E/20% | Shërbim | 4,860.64 € | 4119.19 | 823.84 |
| Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlerë). Kjo është vlera e cila do të duhet të shënohet në Formularin e ofertes dhe do të lexohet gjatë hapjes publike. | | | | 2125.86 |

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE) | |
|---|----------------------|
| EMRI I OE: | Ekrem Q. Salihu B.I. |
| EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE: | Ekrem Salihu |
| NËNSHKRIMI: | |

Nga sa u tha më sipër, OE "Ekrem Q. Salihu B.I." ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme prandaj duhet eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të shpërblehet me kontratë.

Pretendimi nr. 4 kundër OE "Juris Concept LLC":

AK-Komuna e Vushtrisë në letrën standarde të bashkangjitur me njoftimin B58 mbi vendimin, gabimisht ka konstatuar se oferta nga OE "Juris Concept LLC" është e pasuksesshme. Në fakt oferta e prezantuar nga ky OE është ofertë e papërgjegjshme prandaj ky OE është dashur që të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të prezantohet si OE i pasuksesshëm. Kjo për arsye se ky OE nuk ka plotësuar si duhet formularin e tenderit përkatësisht nuk e ka precizuar çmimin e ofertës së tij. Ky fakt konfirmohet përmes procesverbalit të hapjes së ofertave të dt. 30.04.2025 ku ky OE në rubrikën për çmimin total me TVSH ka ofertuar me 2258.05 euro. Ndërsa në rubrikën e çmimit të ofertës pa TVSH ka ofertuar me çmimin prej 1851.60 euro. Shih fig.

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

| | | | | |
|---|---------------------|--|--|--|
| Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke: | VU644-25-2905-2-2-1 | Titulli i Kontraktit Contract Title Naslov ugovora | Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës | |
| Numri i brendshëm Internal No Interni broj | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|-------------------------|---|
| Data e fashimit Date of issue Datum izdavanja | Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas | Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas | Vendi Place Mesto | Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera |
| 30.04.2025 | 30.04.2025, 14:00:00 | 30.04.2025, 14:00:00 | | 4 |

| Nr. Br. | Tenderuesi Tenderer | Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude | Pjesë Lot Lot | e-tenderit e-tender e-ponuda | Çmimi Price Cena € | Çmimi (me TVSH) Price (with VAT) Cena (sa PDV) € | Ndëryshimi/plotësimi Supplement/Amendment Dopuna/Izmjena |
|------------|--|--|---|------------------------------------|-----------------------------|---|--|
| 1. | Ekrem Q. Salihu B.I., Syljeman Vokshi Nr. 64, 10000, Prishtinë | VU25 | Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës | PO | 2125.86 | 2125.86 | JO |
| 2. | Center for Legal Services L.L.C., Rr. "Ali Viti", Ob.4, II.3, B.7, 10000, Prishtinë | CLS-VU-2905 | Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës | PO | 1984.05 | 2341.18 | JO |
| 3. | SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K., rr.Garibaldi, hyrja 3, kati 2, nr.7, 10000, Prishtina | Shërbime juridike Komuna e Vushtrise | Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës | PO | 1439.90 | 1439.90 | JO |
| 4. | Juris Concept L.L.C., Rr. "Garibaldi", II 11, K 2, Nr. 5, 10000, Prishtinë | Shërbime ligjore- Vushtri 2025 | Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës | PO | 1851.60 | 2258.05 | JO |

Në shtetin e Kosovës aktualisht Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) është 18%. Në rastin konkret çmimi i prezantuar pa TVSH nga ky OE është 1851.60 euro ndërsa 18% e kësaj shume është 333.29 euro. Mirëpo nëse e marrim çmimin pa TVSH të prezantuar nga ky OE që është 1851.60 dhe i shtojmë 18% apo 333.29 euro atëherë do të kemi shumën prej 2184.89 euro dhe jo shumën prej 2258.05 të cilën ky OE e ka evidentuar në rubrikën e dedikuar për çmimin total të peshuar me TVSH. Në aspektin matematikor, gabimi i lëshuar nga ky OE mund të konfirmohet edhe nëse marrim çmimin total me tvsh në shumën prej 2258.05 euro dhe e pjesëtojmë me numrin 1.18 (për shkak se TVSH në RKS është 18%), atëherë nënkupton që çmimi pa TVSH do duhej të ishte 1913.78 euro dhe jo 1851.60 euro sikurse është evidentuar nga ky OE në rubrikën e dedikuar për çmimin pa TVSH. Nga të dy këndvështrime e mundshme, devijimi aritmetikor është rreth 3.25% (pra dukshëm mbi 2%).

Në këtë mënyrë OE “Juris Concept LLC” ka dështuar që të përcaktoj çmimin e ofertës së tij (pra mungon çmimi) por njëkohësisht nuk është plotësuar si duhet as formulari elektronik i tenderit përmes platformës eprokurimi. Që të dy këto gabime të këtij OE përbëjnë KUSHTE ADMINISTRATIVE të përcaktuara sipas pikës 10 të UPP ku thuhet se në rastet kur nuk precizohet apo mungon çmimi, tenderi duhet refuzuar pa kërkuar informacione shtesë. Njësoj veprohet edhe kur nuk plotësohet si duhet formulari i tenderit.

| | | |
|--------------|---|---------------------|
| Mungon çmimi | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | Kusht administrativ |
|--------------|---|---------------------|

UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

| | | |
|---|---|---------------------|
| Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | 68 |
| Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | Kusht administrativ |
| Lista e çmimeve është plotësuar por nuk është nënshkruar (tenderët e | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | Kusht administrativ |

Pretendimi nr. 5 kundër OE “Juris Concept LLC”:

Kërkesa nr. 2 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në DT është e formuluar si vijon:

| | |
|--|---|
| Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë të natyres së njëjtë, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). | Dëshmia 2. 1.Lista e kontratave (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet të ofrojë listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e njoftimit për kontratë të këtij tenderi në origjinal, të nënshkruar dhe vulosur nga OE, të deshmuar me referenca apo raporte të pranimeve të shërbimeve të cilat tregojnë vlerën, datën, se kur shërbimi është kryer vlen për institucionet publike kurse nëse shërbimi është kryer për ndonjë kompani private duhet të ofrohet edhe deshmia nga banka për ato referenca. |
|--|---|

Në anën tjetër OE “Juris Concept LLC” ka prezantuar një listë të kontratave si në vijim:

JURIS CONCEPT L.L.C.

LISTA E KONTRATAVE

| Nr. kontratës | Klienti | Data e nënshkrimit | Data e mbarimit | Vlera e kontratës |
|---------------|-------------------|--------------------|-----------------|---------------------|
| I. | Hil Group SH.P.K. | 21.06.2024 | 31.12.2024 | 150.00 euro në muaj |

Pra si fillim në listën e kontratave nuk figuron fare vlera e përgjithshme e kësaj kontrate. Në rubrikën të cilën vet OE e ka përpiluar dhe e ka dedikuar për vlerën e kontratës, nuk e ka shënuar vlerën e kontratës por e ka shënuar "150.00 euro në muaj". Në anën tjetër nuk është bashkangjitur fare kontrata për të cilën bëhet fjalë, me të cilën do të mund të konfirmoheshin të dhënat e prezantuara nga vet OE.

Duke marrë parasysh se kontrata e cila nuk është bashkangjitur në ofertë por e cila është prezantuar nga OE është me një kompani private, atëherë kërkesë eksplicite e DT ka qenë që duhet të prezantohet po ashtu një referencë e shërbimeve ku duhet të tregohet vlera dhe data kur është kryer shërbimi. Më konkretisht në kërkesën e DT të cituar edhe më sipër thuhet si vijon "...te deshmuar me referenca apo raporte te pranimeve të shërbimeve te cilat tregojne vleren, daten, se kur shërbimi eshte kryer...". Në anën tjetër referenca e prezantuar nga ky OE nuk përmend fare vlerën e përgjithshme të kontratës. Pra vlera e kontratës nuk përmendet as në listën e kontratave dhe as në referencë. Rrjedhimisht OE ka prezantuar një kontratë vlera e së cilës nuk dihet pavarësisht që kërkesë shprehimore e DT ka qenë që në referencë të potencohet saktësisht vlera e shërbimeve të realizuara.

Referenca e prezantuar nga ky OE është si në vijim:

28 prill 2025

HIL GROUP SH.P.K., me seli në Zona Kadastrale Krxhile., Graçanicë, me numër unik identifikues 810516239, i përfaqësuar nga Drejtori Gjeneral zt. Agim Thaqi, përmes kësaj:

LETËR REFERENCE


Kujt mund t'i interesojë,

Me këtë letër reference vërtetojmë se Juris Concept L.L.C. dhe Avokatë Kushtrim Prenku dhe Adnan Thaqi kanë kryer shërbimet ligjore në përputhje me marrëveshjen e datës 21.06.2024, e cila ka përfunduar me datë 31.12.2024. Juris Concept L.L.C. në cilësi të ofruesit të shërbimeve ligjore kanë qenë të përkushtuar, profesional, të sakt, duke angazhuar maksimalisht në mbrojtjen e intersave ligjore të kompanisë tonë, duke na ofruar shërbime ligjore të kualitetit dhe cilësisë së lartë.

Për shërbime të ndryshme ligjore penale, civile, administrative, etj, ne rekomandojmë Juris Concept L.L.C dhe Avokatët Kushtrim Prenku dhe Adnan Thaqi, për çdo entitet privat apo publik, duke përfshirë institucionet e nivelit lokal dhe qendror të Republikës së Kosovës.

Me respekt,

HIL GROUP SH.P.K.


z. Agim Thaqi



Vlen të thuhet që ky OE përveç që është administrativisht i papërgjegjshëm dhe nuk ka

arritur që të përmbushë as kërkesën e DT lidhur me kontratat e realizuara në 3 vitet e fundit, ka edhe kërkesa të tjera në DT që nuk ka përmbushur. Pra nga të gjitha këndvështrimet e mundshme, me rastin e rivlerësimit AK-Komuna e Vushtrisë këtë OE duhet të eliminoj si të papërgjegjshëm nga ky aktivitet i prokurimit.

Lidhur me ofertën e dorëzuar nga “Selimaj Legal Consulting Sh.P.K.”, pajtohem me të gjeturat e AK sipas të cilave i njëjti ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Shtojmë vetëm faktin se edhe ky ofertues sikurse tenderuesi i rekomanduar nuk ka precizuar çmimin e ofertës së tij që është kusht administrativ dhe rikonfirmon papërgjegjshmërinë e ofertës së tij.

Nga sa u tha më sipër, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të merr këtë:

VENDIM

MIRATOHET NË TËRËSI si e bazuar kërkesa për rishqyrtim ashtu që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim.

9. Dëmet materiale

Përkrahja mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do të caktohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*